VENDIM
Nr. 361, datë 20.5.2026

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "SISTEMIMI I SHESHIT DHE NDËRTIMI I TREGUT TË FRUTA-PERIMEVE NË LAGJEN 'SKËNDER LIBOHOVA', RRUGA 'PAVARËSIA', BASHKIA LUSHNJË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Sistemimi i sheshit dhe ndërtimi i tregut të fruta-perimeve në lagjen 'Skënder Libohova', rruga 'Pavarësia', Bashkia Lushnjë".
2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Lushnjë.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "truall", me një vlerë të përgjithshme prej 3 832 312 (tre milionë e tetëqind e tridhjetë e dy mijë e treqind e dymbëdhjetë) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 3 832 312 (tre milionë e tetëqind e tridhjetë e dy mijë e treqind e dymbëdhjetë) lekësh përballohet nga buxheti i Bashkisë Lushnjë.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Lushnjë
6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Lushnjë.
8. Bashkia Lushnjë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Lushnjë.
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Lushnjë për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Lushnjë për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.
12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Lushnjë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, si dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “SISTEMIMI I SHESHIT DHE NDËRTIMI I TREGUT TË FRUTA-PERIMEVE NË LAGJEN ‘SKËNDER LIBOHOVA’, RRUGA ‘PAVARËSIA’, BASHKIA LUSHNJË

NR.	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)									VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM									VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME (kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)
													ARË			TRUALL			NDËRTESË				
	Emri	Atësia	Mbiemri	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m2)	"Truall" (m2)	"Ndërtesë" (m2)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)		
1	Fatime Flamur Ilmi Julind Aldo	Islam Muastafa Ramazan Ilmi Ilmi	Hoxha Hoxha Gorrica Gorrica Gorrica	8572	7/3	TRUALL	168		168		30	160				168.0	8954	1,504,272				1,504,272	
2	Zybë Dylbere Albert Behije Hurma Naxhije Lutfije Besnik Shpresa Vera Violeta Afërdita Entela Donika Natasha Bajame Lavdije Astrit Syme Nertila Alketa Luiza Ramazan Hane	Dervish Ramazan Shazivar Shazivar Shazivar Shazivar Shazivar Arshin Arshin Arshin Arshi Arshin Rrapush Rrapi Rrapush Rrapush Rrapush Rrapush Alush Kapllan Kapllan Kapllan Kapllan Shazivar	Hoxha Liko Lundraxhiu Lundraxhiu Prifti Ziu Elezi Hoxha Ziu Gjoka Nallbani Hoxha Qafa Haxhiu Hasanlliu Kashari Liçi Haxhiu Haxhiu Haxhiu Kuqi Gjyshja Haxhiu Çanaku	8572	7/196	TRUALL	260		260		18	62				260.0	8954	2,328,040				2,328,040	
VLERA TOTALE																						**3,832,312**	